



1<sup>e</sup> REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 47/2 Prot.

Shkodër, më 26/01/2022

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE ✓

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,  
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- **Vendimin Administrativ nr. 101 datë 11.10.2021** për subjektin "BLINARS" SHPK me NIPT M06818003B, me administrator znj. Hydajete Guri, me adresë: Njësia Administrative Rrethina, Dobrac, Rruga Nacionale Shkodër - Hani Hotit, km.2, në ambientet e tregut Fruta Perime, magazina nr.13, Shkodër.
- **Vendimin me nr. 2662/4 prot., datë 14.12.2021** për Rikuperimin me Forcë të Borxhit doganor ndaj debitorit subjektit "BLINARS" SHPK me NIPT M06818003B.

Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

Aida DIZDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave  
Dega e Doganës Shkodër

Nr. 979/5 Prot.

Shkodër, më 11/10/2021

**V E N D I M**  
**Nr. 101, Datë 11.10.2021**

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, mori në shqyrtim formularin e rivlerësimit njoftuar me shkresën 979/3 prot., datë 05.08.2021, procesverbalin nr. 979/4 prot., datë 08.10.2021 të mbajtur nga Kontrolli Aposterior pranë Degës së Doganës Shkodër, në lidhje me rivlerësimin doganor të **Subjektit "BLINARS", sh.p.k me NIPT M06818003B, me administrator znj. Hydajete Guri**, me adresë: Njësia Administrative Rrethina, Dobrac, Rruga Nacionale Shkodër - Hani Hotit, km.2, në ambientet e tregut Fruta Perime, magazina nr.13, Shkodër.

Pasi u shqyrtua dokumentacioni i mësipërm, rezulton se:

Subjekti **"BLINARS", sh.p.k me NIPT M06818003B**, me deklaratën doganore: R 3213 datë 22.02.2021, ka importuar dhe deklaruar artikulli, "patate për konsum", me kod tarifor \*1701\*, në kushtet e lëvrimit RS/CPT.

Praktika doganore e sipërcituar, është përzgjedhur nga sistemi doganor në "Kanalin Jeshil" sipas shkresës së DPD-së nr.10312 prot., datë 09.06.2021 "Mbi problematikat e vlerësimit doganor për muajin Maj 2021", protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.979 prot., datë 10.06.2021.

Kontrolli Aposterior, në zbatim të nenit 49 të ligjit 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka ushtruar kontroll dokumentar dhe ka konstatuar se;

Për R 3213 datë 22.02.2021, ka importuar dhe deklaruar artikulli, "patate për konsum", me kod tarifor \*1701\*, në kushtet e lëvrimit RS/CPT, të përzgjedhur në kanal jeshil, nuk janë vlerësuar sipas të dhënave të disponueshme, praktikave analoge apo historikut të këtij subjekti, theksuar dhe me shkresën e DPD-së nr.10312 prot., datë 09.06.2021 "Mbi problematikat e vlerësimit doganor për muajin Maj 2021", e për rrjedhojë subjektit i linden detyrime shtesë në shumën 119.747 lekë.

Sa më sipër subjekti nuk plotëson kushtet bazë për tu kaluar me transaksion (shih R 802 datë 17.03.2021 Shkodër, R 4415 datë 04.03.2021 etj., me të njëjtin subjekt importues). I mungon kontrata mes palëve, Swift bankar, proforma etj dhe ka një historik me ndërhyrje.

Mallrat e importuar nga shoqëria importuese, "Patate për konsum" dhe pranimi apriori i çmimit të deklaruar nga ana e subjektit nuk ka si të mos bëhet objekt shqyrtimi nga autoriteti doganor, kur çmimi i mallit të importuar është dukshëm më i ulët se çmimet e të dhënave të disponueshme dhe praktikave analoge.

Duke qenë se vlerat e produkteve të importuara janë konsiderueshëm më të ulëta se sa ato të marra nga të dhënat e disponueshme dhe në mungesë të dokumentacionit justifikues për të vërtetuar vlerën realisht të paguar, me qëllim standartizimin e vlerësimit doganor, janë rivlerësuar sipas formularit të

rivlerësimin doganor, duke u bazuar në historikun periodik të tij dhe rivlerësimin e praktikave doganore analoge.

Subjekti, pasi është njohur me formularin e rivlerësimin doganor, dërguar me shkresën nr.979/3 prot., datë 05.08.2021, për të cilin për të cilin ka marrë dijeni me datën 27.08.2021 ka pranuar rivlerësimin, prandaj Kontrolli Aposterior vlerëson se subjekti duhet të paguajë detyrim shtesë në shumën 119.627 lekë.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në analizim dhe shqyrtim të dokumentacionit të mësipërm, pikën 3, të nenin 70 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM –në Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit nr. 102.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Pikën 4.5 dhe 4.6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, date 23.1.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganor” dhe Udhëzimin nr. 05, datë 26.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi Procedurat Standarte të Funkcionimit të Sektorit të Vlerësimin Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”.

#### V E N D O S I:

1. Për deklaratën doganore: R 3213 datë 22.02.2021 të deklaruar nga **Subjekti “BLINARS”, sh.p.k me NIPT M06818003B**, të zbatohet vlerësimi doganor bazuar në pikën 3, të nenin 70 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Detyrimi doganor shtesë që duhet paguar është **119.627** (njëqindëntëmbëdhjetë e gjashtëqindënjëzeteshtatë) lekë.
3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizimin e borxhit doganor.
4. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Kontrolleve të Akcizës dhe Pas zhdoganimit për pasqyrimin e vendimit në sistemin AW dhe amendimin e deklaratës doganore.
5. Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

KRYETAR

Aida DIZDARI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**  
**DEGA DOGANËS SHKODËR**

Nr. 2662/14 Prot.

Shkodër, më 14/12 2021

**V E N D I M**

Për rikuperimin me forcë të borxhit doganorë ndaj subjektit  
“BLINARS”, sh.p.k me NIPT M06818003B

Dega e Doganës Shkodër me vendimin Nr. 101, datë 11.10.2021 ka vendosur kontabilizimin dhe arkëtimin e borxhit doganor në shumën totale **119.627 lekë**, për subjektin “BLINARS”, sh.p.k me NIPT M06818003B, me administrator zj. Hydajete Guri, me adresë: Njësia Administrative Rrethina, Dobrac, Rruga Nacionale Shkodër - Hani Hotit, km.2, në ambientet e tregut Fruta Perime, magazina nr.13, Shkodër.

Ky vendim i është dërguar për njoftim subjektit të mësipërm, përmes njoftimit me postë rekomandë me Lajmërim Marrje nr. 979/5 prot me Kod Postar RR 652 233 024 AA me anë të së cilës nuk ka marrë njoftim “zarfi i kthyer”. Dega e Doganës Shkodër me shkresën Nr. 2662/1 datë 08.11.2021 ka bërë “Kërkesë për Shpallje Publike” në Qendrën Kombtare të Biznesit për te cilën sipas faqes zyrtare me ciklim (nr.18874prot., datë 11.11.2021) QKB ka bërë afishimin në faqen e saj zyrtare <https://qkb.gov.al/shpallje/njoftime-nga-organet-doganore/> për vendimin administrativ Nr. 101, datë 11.10.2021. Me shkresën Nr.2662/3prot., datë 17.11.2021 kemi bërë “Shpallje Publike ne Degë” e cila ka qëndruar e afishuar nga data 17.11.2021 deri më 28.11.2021. Subjektit megjithëse i ka kaluar afati ligjor i ankimit dhe afati i ekzekutimit vullnetarë, nuk ka likuiduar borxhin doganor të lindur sipas vendimit të sipërpërmendur.

Në këto kushte në bazë të vendimit Nr. 101, datë 11.10.2021 të Degës Doganës Shkodër, me qëllim për rikuperimin me forcë të borxhit doganorë në shumë prej **119.627 lekë**, për subjektin “BLINARS”, sh.p.k me NIPT M06818003B, me administrator zj. Hydajete Guri, që ka ndaj Degës Doganës Shkodër, në zbatim të nenit 280 të Ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 511 e vijues të K.Pr.C dhe udhëzimit Nr.4. datë 07.04.2016 të Drejtorisë Përgjithshme Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimit dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”.

**V E N D O S A Q Ë:**

- 1) Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë sendet me vlerë të çmuar, valutë të huaj të depozituara në bankë, që i përkasin subjektit “BLINARS”, sh.p.k me NIPT M06818003B, me administrator znj. Hydajete Guri, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- 2) Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit .
- 3) Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme të përcaktuar në vendimin Nr. 101, datë 11.10.2021 të Degës së Doganës Shkodër, **si dhe të kamatë vonesave të lindura** në bazë të nenit 245 pika 1/b të Kodit Doganorë deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.

**KRYETAR**

Aida DIZDARI